



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan – (çështje e shtyrë e nga mbledhjet plenare të datave 02.05.2024, 16.05.2024 - seanca në orën 10:00.)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 3. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Gentiana Muçaj | <i>(anëtare)</i> |
| 6. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *{...}, Inspektor jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
9. *{...} (avokate).*
10. *Isida Koka, Këshilltar pranë Kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
11. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan – (çështje e shtyrë e nga mbledhjet plenare të datave 02.05.2024, 16.05.2024 - seanca në orën 10:00.)

Ilir Rusi: Mirëmëngjesi të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas rendit të ditës dhe për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, mbledhjen e deklaroj të hapur. Ju bëj me dije që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), për arsye institucionale nuk do jetë prezent në këtë mbledhje. Mbledhja do të drejtohet nga unë Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ilir Rusi.

Keni diskutime në lidhje me përmbajtjen e rendit të ditës?

Meqenëse nuk kemi diskutime, pika e parë e tij ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Ftoj administratën të njoftojë përfaqësuesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe përfaqësuesen e magjistrates.

(Futen në sallën e mbledhjes z. {...}, përfaqësues i ILD-së dhe znj. {...}, avokate e gjyqtares znj. {...}.)

Ilir Rusi: Përshëndetje!

Në vijim të kësaj seance dëgjimore, prezent në sallë z. {...}, me detyrë inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i cili është pajisur me autorizimin nr. 385/23 datë 28.05.2024 nga ILD, që të përfaqësojë ILD-në në procedimin disiplinor të filluar ndaj magjistrates {...} me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Gjithashtu është prezent edhe përfaqësuesja e znj. {...}, znj. {...} e cila ka paraqitur NIPT-in dhe licencën përkatëse, njëkohësisht është edhe prezent në këtë seancë; dhe i janë bërë me dije i gjithë dokumentacioni i kërkuar prej saj në kohë dhe është konfirmuar edhe marrja i këtij dokumentacioni.

Në vijim të kësaj seance dëgjimore, ftoj përfaqësuesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili Inspektori e ka shprehur qëndrimin e tij dhe meqenëse ne e kemi me shkrim, në mënyrë shumë sintetike, të prezantojë qëndrimin e vet në lidhje me ecurinë e këtij procedimi disiplinor.

{...}: Për sqarim. Në seancën e mëparshme, janë parashtruar nga...

Ilir Rusi: Atë ju thashë, janë parashtruar nga Inspektori dhe nuk përmenda që janë parashtruar nga zonja {...}, por përmenda termin Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili sipas rastit përfaqësohet nëpërmjet autorizimit nga personat përkatës. Dhe zonja {...} i ka parashtruar. Prandaj ju thashë i kemi edhe me shkrim qëndrimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Meqenëse ju z. {...} jeni përfaqësues i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe meqenëse ne i kemi me shkrim, dhe i janë vënë edhe në dispozicion subjektit, kërkoj në mënyrë sintetike për të shprehur qëndrimin tuaj në lidhje me ecurinë e mëtejshme të këtij procedimi disiplinor.

{...}: Megjithëse nga përfaqësuesja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në seancën e mëparshme janë paraqitur me shkrim dhe janë parashtruar dhe gjatë seancës. Unë i qëndroj atyre parashtrimeve dhe në përfundim kërkoj që Këshilli i Lartë Gjyqësor, të administrojë provat e paraqitura nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këtë procedim disiplinor dhe në mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja “dh”, nenit 111, pika 1, shkronja “b”, e ligjit nr. 96/2016, të vendosë:

Caktimin ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, e Kushtetutës (shkronja "b"), dhe neni 104, pika 3, e ligjit nr. 96/2016, dhe në përfundim të vendosë masën disiplinore të "*Shkarkimit nga detyra*".

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...}!

Ftoj përfaqësuesen e zonjës {...}, znj. {...}, për të bërë parashtrësit e veta.

Ju i keni me shkrim?

Av.{...}: Po!

Ilir Rusi: Atëherë, meqenëse i keni me shkrim, do i depozitoni dhe në mënyrë të përmbledhur do të parashtroni qëndrimet tuaja.

Njëkohësisht i bëj me dije Këshillit që është paraqitur dhe licenca e avokatit dhe NIPTI, njëkohësisht dhe prokura përkatëse, në lidhje me zonjën {...}.

Po, - fjala për ju!

Av.{...}: E nderuar zonja Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor!

I nderuar zoti Kryetar i kësaj seanca, dhe të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Fillimisht, para se t'ju prezantojmë rrethanat për shkak të të cilave e përfaqësuara prej meje aktualisht rezulton të jetë me statusin e gjyqtares së pezulluar nga ushtrimi i detyrës dhe arsyet përse kundërshtomë procedurën e fillimit të hetimit të disiplinor, ju kërkujmë pezullimin e këtij procedimi disiplinor të kërkuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë sipas vendimit nr.{...} datë 07.02.2024, deri në përfundim të gjykimit të çështjes penale në Gjykatën e Lartë, bazuar ky kërkim në ligjin 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas bazës ligjore të kërkimit; dhe lënien në fuqi të vendimit nr.346, 27.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor në lidhje me pezullimin nga ushtrimi i detyrës së magjistrates, deri në përfundim të Gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe marrjes së vendimit penal formë të prerë në kuptimin material.

E përfaqësuara prej meje, magjistratja {...} rezulton punonjëse e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan që nga viti 1984, teksa nga viti 1993 e në vazhdim ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Me vendimin nr. 347, datë 27.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 151/1, germa “a” dhe nenin 155 të ligjit 96/2016 është vendosur pezullimi nga detyra e kësaj magjistrateje, me detyrë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Pezullimi nga detyra i gjyqtares sipas këtij vendimi është bërë për shkak të çështjes penale të filluar nga SPAK sipas procedimit penal nr. 209/2021 dhe caktimit të masës së sigurimit “arrest në shtëpi”.

Çështja e sipërme penale është gjykuar në dy shkallë gjykimi dhe konkretisht:

Me vendimin nr. 45, datë 04.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë,

ndaj të përfaqësuarës prej meje është dhënë një vendim fajësie. Dua të citoj këtu faktin se ky vendim fajësie është marrë me shumicë votash, (pasi relatorja e çështjes ka dalë me vendim pafajësie në pakicë në favor të të përfaqësuarës prej meje).

Vendimi nr. {...}, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, është ankimuar nga e përfaqësuarja prej meje në Gjykatën e Posaçme të Apelit dhe kjo e fundit në përfundim të gjykimit ka dalë me vendimin nr. 2, datë 26.01.2024 me të cilin ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr.45, datë 04.07.2023 dhe këtë vendim e përfaqësuarja prej meje {...} e ka marrë të arsyetuar nga kjo gjykatë në datë 30.03.2024 dhe ka ushtruar të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë brenda afatit ligjor. Në momentin e marrjes së këtij vendimi, është njohur vetëm me një vendim fotokopje të dërguar nga kryesekretaria e asaj gjykate me shënimet përkatëse përbri emrit të çdo gjyqtari me siglën “dora vetë”. Deri në këtë moment kuptohet që ky vendim është marrë në mënyrë unanime nga të tre gjyqtarët. Në fakt e vërteta rezultoi të ishte ndryshe, për shkak se nga avokatja e saj, pasi ajo studioi dosjen përkatëse, u zbulua që vendimi nuk ishte unanim, por ishte me 3 mendime të ndryshme, ishte një vendim i marrë pa shumicë votash. Përveç, vendimit të arsyetuar të gjykatës, në dosjen gjyqësore rezultojnë edhe “Mendim Paralel” i gjyqtarit {...} dhe “Proces-verbal” përmbledhës i motiveve kundërshtuese i Gjyqtarit {...}. Të tre këto akte përmbanin arsytetime të ndryshme, të cilat janë bërë prezent në përmbajtjen e rekursit.

Vendimi nr. {...}, datë 26.01.2024 i Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është një vendim absolutisht i pavlefshëm si vendim i marrë në kundërshtim me parashikimet e neneve 381, 383/2 të Kodit të Procedurës Penale. Kështu ky vendim i arsyetuar i Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar... (ndërpritet audio).

Ilir Rusi: Vazhdoni!

Av.{...}: Për mendimin tonë nuk jemi në rastin e gjësë së gjykuar. Vërtetë çështja ka përfunduar në apel, por nga e përfaqësuarja prej meje është paraqitur rekurs, aq më tepër jemi përpara rastit që vendimi i Gjykatës së Apelit për ne është i pavlefshëm.

Mendojmë që është i cenueshëm dhe edhe në kushtet e daljes së një vendimi të Gjykatës Kushtetuese me nr. {...}, datë 11.04.2024. Duke mos pasur një vendim shumice por një mendim paralel, një procesverbal përsëri kundërshtimi, çuditërisht na del një vendim i gjyqtarës {...} i cili lë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Mendojmë që në analizën që ka bërë Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr. {...}, datë 11.04.2024, jemi pikërisht përpara këtij rasti, nuk ka një vendim shumice. Mendojmë që është i cenueshëm vendimi i Gjykatës së Apelit. Çështja për mendimin tonë do kthehet përsëri në Gjykatën e Apelit dhe të gjitha këto që do bëhen ndaj të përfaqësuarës prej meje do të zhbëhen, por do kenë pasoja, sigurisht që do kenë pasoja dhe për të. Nuk jemi para parimit të gjësë së gjykuar në aspektin material. Pavarësisht se në Gjykatën e Apelit është shqyrtuar çështja, jo vetëm përderisa nuk kemi një vendim unanim, një vendim shumice, por kemi siç referova në tre raste, por edhe për faktin që është bërë një ankim. Ankimi është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë. Pra nuk janë shteruar të gjitha mjetet e ankimit.

Në këto kushte mendojmë që nuk duhet të pranohet kërkesa e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për “shkarkimin nga detyra”, por të qëndrojmë në kushtet e pezullimit sikurse është vendosur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Faleminderit! ...deri në pritje të shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja {...}!

Keni ndonjë parashtrësë si përfaqësues i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë?

{...}: Po!

Atëherë, për sa parashtroi përfaqësuesja e subjektit të procedimit disiplinor, janë të njëjtat fakte dhe rrethana të cilat janë parashtruar edhe gjatë fazës së hetimit disiplinor, për të cilat, në përfundim të hetimit, faktet dhe rrethanat janë bërë pjesë e raportit përfundimtar, të cilave dhe u është dhënë zgjidhje në këtë raport.

Por gjithsesi, në lidhje me kërkesën për pezullim të përfaqësueses së magjstrates, theksoj se fakti penal për të cilin është akuzuar magjistratja subjekt procedimi disiplinor, është provuar me vendimin gjyqësor nr. {...}, datë 04.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të

Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. {...}, datë 26.01.2024, vendim penal i cili është i formës së prerë në kuptim dhe zbatim të nenit 462, pika 3, shkronja “b”, lidhur me nenin 428, pika 1, shkronja “a” e K.Pr.Penale.

Në këto kushte, mendoj dhe vlerësoj se nuk jemi në kushtet e pezullimit sipas nenit 126 të ligjit 96/2016 “Për statusin”.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...}!

Po, -fjala për ju zonja {...}.

Av. {...}: Atëherë, bashkëngjitur me parashtresën tonë që kemi me shkrim, ju paraqesim edhe prova (janë aktet që cituam në parashtresë): Vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë 2/2014; Vendimin penale nr. {...}, datë 04.07.2024 (2023) të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vendimi i gjyqtarit me shumicë dhe vendimin e gjyqtares relatores në pakicë; Vendimin nr. {...}, datë 26.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit të gjyqtares {...}; Aktin mendim paralel të gjyqtarit {...}; Aktin procesverbal përmbledhës i motiveve kundërshtuese të gjyqtarit {...}; dhe rekursin e datës 14.05.2024 të depozituar në Gjykatë të Lartë nga e përfaqësuara prej meje {...}.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja {...}!

Keni ndonjë pyetje?

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Dy pyetje vetëm për sqarim.

Ju thatë në parashtresat tuaja që aktualisht është në fuqi masa e pezullimit nga

detyra për shkak se kjo masë është marrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, apo jo?

Av.{...}: Po!

Klodian Kurushi: Atëherë, bëj një referim tek neni 151 i ligjit “Për statusin”. Masat jepen në dy raste: kur magjistrati ndodhet nën masën e sigurisë “arrest në burg” dhe vendimin në këtë rast e merr Këshilli i Lartë Gjyqësor, për pezullimin nga ushtrimi i funksionit; dhe rasti i dytë është kur ai merr cilësinë e të pandehurit, apo jo? Dhe masa humbet fuqinë e vet në rastet kur përfundon afati i paraburgimit ose kur i pandehurit i pushohet çështja, merr vendim pafajësie apo merr vendim dënimi të formës së prerë. Dakord deri këtu.

Pyetja që unë kam për ju është: Klientja juaj, magjistratja zonja {...}, aktualisht sot e ka cilësinë e të pandehurës apo jo? Sipas mendimit tuaj.

Av.{...}: E ka.

Po, e ka cilësinë e të pandehurës.

Klodian Kurushi: Domethënë është e pandehur.

Av.{...}: Nuk janë shteruar mjetet e ankimit.

E ka cilësinë.

Më fal, e ka cilësinë e të dënuarës. Më falni! Emocionet bëjnë të vetën.

Klodian Kurushi: Ok!

E para, pra ka cilësinë e të dënuarës, jo të pandehurës.

Av.{...}: Po!

Klodian Kurushi: Atëherë, kur ka cilësinë e të dënuarës, mund të jetë në fuqi

masa e pezullimit që kemi caktuar neve?

Av.{...}: Po sepse ne pretendojmë, mendojmë që nuk janë shteruar mjetet e ankimit dhe kemi një fakt shumë të rëndësishëm, një vendim të Gjykatës Kushtetuese, që është shprehur në lidhje me rastin konkret. Kemi tre mendime të ndryshme të gjykatës së apelit.

Klodian Kurushi: Gjykata Kushtetuese nuk është shprehur për rastin konkret.

Av.{...}: Jo, -për një rast të ngjashëm.

Klodian Kurushi: Të ngjashëm, por jo për rastin konkret.

Av.{...}: Të ngjashëm. Të ngjashëm, në të cilin referohet.

Klodian Kurushi: Pra ju thoni, pavarësisht faktit që ajo është e dënuar, masa e pezullimit është në fuqi.

Av.{...}: Atëherë, ne kërkojmë pezullimin e procedimit administrativ të filluar nga ILD dhe mosmarrjen e masës së kërkuar prej tyre.

Klodian Kurushi: Mirë, faleminderit!

Nuk kam pyetje tjetër.

Ilir Rusi: Atëherë, si përfaqësuesi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ju zonja {...} si përfaqësuesja e magjistrates, keni akte apo prova të tjera për të dorëzuar përveç atyre çfarë përmendët në këtë seancë?

Av.{...}: Jo, nuk kemi.

Jo! Parashtrësën dhe provat i kemi...

Ilir Rusi: Atëherë, ftoj administratën të marrë aktet e paraqitura në këtë seancë, njëkohësisht ftoj edhe përfaqësuesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për t'u shprehur në lidhje me kërkesën e përfaqësueses së magjistrates znj. {...}, në lidhje me pezullimin e këtij procedimi disiplinor. Çfarë qëndrimi keni?

{...}: Për kërkesën për pezullim u shpreha qëparë. Nuk jemi dakord që procedimi disiplinor të pezullohet por të vijojë përfundimi.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Meqenëse ju nuk keni pyetje të ndërsjella si përfaqësues, njëkohësisht edhe anëtarët nuk kanë pyetje ndaj përfaqësuesve të Inspektorit dhe të magjistrates, ju ftoj të largoheni, me qëllim që Këshilli të vazhdojë me diskutimet.

(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së, z. {...} dhe përfaqësuesja e gjyqtarës, znj. {...}. Gjithashtu shkëputet edhe lidhja me të tretët. Mbledhja vijon vetëm në prezencë të anëtarëve.)

(Rifuten në sallën e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së, z. {...} dhe përfaqësuesja e gjyqtarës, znj. {...}. Gjithashtu mundësohet edhe lidhja nëpërmjet platformës online.)

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të këtij procedimi disiplinor, Këshilli i Lartë Gjyqësor mori në shqyrtim kërkesën e avokates znj. {...} si përfaqësuese ligjore e magjistrates znj. {...}, në lidhje me kërkesën e saj për pezullimin e këtij procedimi disiplinor, Këshilli vendosi:

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e procedimit disiplinor dhe njëkohësisht vijimin e këtij procedimi disiplinor.

Meqenëse jemi në këtë moment procedural, ju bëj me dije, i kërkoj edhe një herë palëve në proces, përfaqësuesit të ILD-së dhe avokates znj. {...} si përfaqësuese ligjore e

znj. {...}, nëse kanë prova të tjera për të paraqitur apo jo. Nëse keni prova të tjera apo jo.

{...}: Me shkrim i kam paraqitur konkluzionet përfundimtare.

Ilir Rusi: Prova të tjera keni?

(Nuk dëgjohet në audio përgjigjja e z. {...}).

Ilir Rusi: Zonja {...} si përfaqësuese ligjore e znj. {...}?

Av.{...}: Nuk kemi prova të tjera, i nderuar.

Ilir Rusi: Përveç atyre të paraqitura në seancën e sotshme.

Av.{...}: Përveç atyre të paraqitura bashkangjitur parashtresës.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ftoj përfaqësuesin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të shprehur edhe një herë qëndrimin e tij mbi vijimin e këtij procedimi disiplinor, dhe qëndrimin përfundimtar të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

{...}: Faleminderit!

Atëherë, në përfundim të procedimit disiplinor, në analizë të dokumentacionit të administruar në kuadër të këtij procedimi disiplinor, rezultoi e provuar se në rastin konkret, nga ana e magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, është kryer shkelja disiplinore e parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe nga neni 104, pika 3, e ligjit 96/2016, i ndryshuar, pasi konstatohet se magjistratja {...} është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, siç parashikon dhe neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në përmbajtje të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë (të posaçme) e lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit, rezulton se për caktimin e masës disiplinore të shkarkimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte: a) gjyqtari të jetë dënuar për kryerjen e një krimi; dhe se b) vendimi i dënimit të jetë i formës së prerë.

Vepra penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” për të cilën është gjetur fajtor dhe është dënuar gjyqtare {...}, parashikohet si krim nga neni 319/ç i Kodit Penal.

Ndërsa neni 1/2 i Kodit Penal parashikon se: “Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij kodi”; Ndërsa neni 32 i K.Penal, parashikon masat e dënimit me burgim sipas natyrës së veprës penale “Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet. Ndërsa për kundërvajtje penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga pesë ditë deri në dy vjet”.

Për sa i përket kushtit të dytë të kërkuar nga dispozita, atë të marrjes së vendimit të dënimit formë të prerë, nga aktet e administruara rezultoi se vendimi nr. {...}, datë 04.07.2023 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe vendimi penal nr. {...}, datë 26.01.2024 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Krimin e Organizuar, i cili ka lënë në fuqi vendimin e sipërcituar, janë vendime gjyqësore të cilat janë dhënë pas hyrjes në fuqi të ligjit me ndryshimet e vitit 2017 të Kodit të Procedurës Penale, në këto kushte plotësohet edhe kushti për faktin se vendimi i gjykatës është i formës së prerë.

Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara, duke mbajtur në konsideratë natyrën e shkeljes disiplinore, ajo e kryerjes së një krimi për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë; faktin që shkelja disiplinore në rastin konkret përbën shkelje shumë të rëndë disiplinore; provohet se magjistrate {...} ka diskretituar pozitën dhe figurën e magjistratit, ka cenuar rëndë imazhin e drejtësisë dhe ka ulur besimin e publikut tek dhënia e drejtësisë.

Për sa më sipër, kërkojmë nga Këshilli I Lartë Gjyqësor të administrojë provat e paraqitura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në këtë procedim disiplinor dhe në

mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja "dh", nenit 111, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 96/2016, të vendosë:

Caktimin ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja "b" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nga neni 104, pika 3, e ligjit nr. 96/2016, dhe të vendosë në përfundim masën disiplinore të "Shkarkimit nga detyra".

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti {...}!

Ftoj përfaqësuesen ligjore znj. {...}.

Av. {...}: Atëherë, sikurse parashtrua, mendojmë që jemi në kushtet kur kërkesa e paraqitur nga ILD nuk duhet të pranohet, dhe ne kërkojmë lënien në fuqi të vendimit të KLGJ-së për “pezullimin e ushtrimit të detyrës së magjistrates”, deri në përfundim të gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe marrjes së një vendimi penal të formës së prerë në kuptimin material, pasi në kushtet e një gjykimi në Gjykatën e Apelit me tre mendime të ndryshme, nuk mendojmë që jemi në kushtet e marrjes së formës së prerë të këtij vendimi, nuk jemi në kushte, pasi kemi një mendim paralel, një procesverbal ku shprehet krejtësisht ndryshe dhe anëtari tjetër i gjykatës, mendojmë që këto kushte nuk jemi në kushtet e parimit të gjësë së gjykuar, në aspektin material vendimi nuk ka marrë formë të prerë, prandaj mendojmë që duhet të pritet vendimi i Gjykatës së Lartë. Një rast i tillë, një rast i ngjashëm është shqyrtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese e cila me vendimin e saj nr. 28/2024 është shprehur që vendimi i tillë cenon parimet kushtetuese dhe vjen në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për formën e prerë.

Në këto kushte mendojmë që për magjistraten {...} duhet të mbetet në fuqi vendimi juaj për pezullimin e procedimit disiplinor, të lihet në fuqi vendimi juaj që ka vendosur “pezullimin e magjistrates nga ushtrimi i detyrës”, deri në marrje të një vendimi të Gjykatës së Lartë, i cili mendojmë që do të shprehet për prishjen e vendimit të

Gjykatës së Apelit. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit si përfaqësuesit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe përfaqësueses ligjore! Ju ftoj të largoheni, me qëllim që Këshillit të procedojë me vendimmarrjen përkatëse. Prisni për t'ju komunikuar vendimmarrjen.

(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së, z. {...} dhe përfaqësuesja e gjyqtares, znj. {...}. Gjithashtu shkëputet edhe lidhja me të tretët. Mbledhja vijon vetëm në prezencë të anëtarëve.)

(Rifuten në sallën e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së, z. {...} dhe përfaqësuesja e gjyqtares, znj. {...}. Gjithashtu mundësohet edhe lidhja nëpërmjet platformës online.)

Ilir Rusi: Në vijim të procesit të rregullt dhe ligjor, Këshilli i Lartë Gjyqësor mori vendim për riçeljen e shqyrtimit të këtij procedimi disiplinor dhe i jap fjalën zotit Kurushi i cili ka për të adresuar pyetje ndaj përfaqësueses ligjore të znj. {...}, znj. {...}. Fjala për ju zoti Kurushi ndaj përfaqësueses ligjore, për të qartësuar të gjitha kërkimet dhe parashtrësat e bëra nga zonja {...}, si përfaqësuese ligjore e magjistrates {...}.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Kisha vetëm një sqarim, sepse në konkluzionet përfundimtare, siç ishit edhe ju në dijeni, ju keni kërkuar pezullimin, dy pezullime: Pezullimin e procedimit dhe vazhdimin e pezullimit nga funksioni të zonjës {...}. Dakord?

Jemi në fazën e konkluzioneve përfundimtare.

Këshilli mori një vendim, që ju refuzoi kërkesat.

E kuptuat këtë vendim?

Av. {...}: Patjetër!

(Flet pa ndezur mikrofonin.)

Klodian Kurushi: Ok!

Ju e ripërsëritët prapë kërkesën, apo jo?

Ilir Rusi: Mund të ndërhyj?

Fjala e zonjës {...}, si përfaqësuese e magistrates {...}, nuk u regjistrua. Ju lutem, shpreheni edhe një herë. Ju lutem!

Av. {...}: Ndjesë!

Sigurisht që u kuptua. U rrëzua kërkesa në lidhje me pezullimin e procedimit disiplinor të kërkuar nga ILD.

Klodian Kurushi: Ju e ripërsëritët prapë kërkesën?

Av. {...}: Unë nuk ripërsërita kërkesën. Unë kërkoja sikurse kemi parashtruar edhe tek... (ndjesë, por nuk më latë që t'i lexoja domethënë të tëra për efekt të kohës. Janë me shkrim, sigurisht, por ndryshe kur unë do t'i referoja vetë.) ...dhe pika e dytë është lënia në fuqi e vendimit nr. 346, të këtij Këshilli, të datës 27.07.2022, në lidhje me pezullimin nga ushtrimi i detyrës së magistrates, deri në përfundim të gjykimit në Gjykatën e Apelit. Më fal, në Gjykatën e Lartë.

Klodian Kurushi: Një pyetje tjetër, e fundit fare.

Përveç këtyre dy kërkesave, përfaqësuesi i ILD-së ka kërkuar “shkarkimin” e klientes suaj. Ju keni ndonjë shpjegim, ndonjë pretendim, ndonjë deklaram, ndonjë qëndrim për këtë?

Av. {...}: Mospranimin e kërkesës. Dhe prandaj themi t'i qëndrojmë pezullimit, deri në pritje të vendimit të Gjykatës së Lartë. Kemi një vendim të Gjykatës së Apelit shumë të brishtë, një vendim i dhënë me mendime paralele. Çfarë do bëhet me magistraten në rast hipotetik që ky vendim mund të prishet. Them i brishtë dhe

mund të prishte (përderisa kemi edhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese).

Pra mospranimin e kërkesës së paraqitur nga ILD për “shkarkimin e magistrates {...}”, pasi i kemi parashtruar të gjitha në parashtrësën tonë. Kemi të bëjmë me një vendim të cënueshëm; kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese; nuk janë shteruar mjetet e ankimit; kemi edhe bazueshmërinë edhe në provat çfarë kemi paraqitur dhe në dispozitat ligjore janë shkelur dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Faleminderit!

Ndjese që nuk qeshë e qartë ndoshta, por ngaqë po t’i kisha lexuar...

Faleminderit!

Ndjese për kohën, për paqartësinë.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Përgjigjet znj. {...}.

Av. {...}: Mospranimi, rrëzimi, rrëzimi i kërkesës për “shkarkimin nga detyra” dhe qëndrimin, lënien në fuqi të masës së vendosur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. nr.346, datë 27.07.2022 (të këtij Këshilli). Të vazhdojë e pezulluar derisa të shprehet me vendim Gjykata e Lartë në bazë të rekursit të paraqitur nga klientja ime.

Ilir Rusi: Atëherë, si drejtues i seancës, më duhet të sqaroj vetëm një togfjalësh që u shprehët që “nuk më latë për të paraqitur...”.

Ju lutem, duke iu referuar përcaktimeve të nenit 142 të ligjit 96, në lidhje me statusin e magistratëve, përcaktohet që (në pikën 3/b të saj): “3.... b) magistrati ose përfaqësuesi i tij paraqesin argumentet mbrojtëse.”. Pika 4 përcakton: “4. Përmbajtja e parashtrimeve me shkrim nuk përsëritet gjatë seancës dëgjimore.”.

Dhe meqenëse ju i keni paraqitur me shkrim, ju është bërë me dije që mos t’i përsërisni ato, por natyrisht që të jeni argumente mbrojtës.

Av. {...}: Ndjesë!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Av. {...}: Faleminderit ju!

Ilir Rusi: Keni pyetje të tjera?

Keni diskutime?

Keni pyetje të ndërsjella si përfaqësues?

(Nuk ka diskutime.)

Të vazhdojmë me procedimin e mëtejshëm, duke ne u tërhequr, duke u larguar përfaqësuesit dhe të tërhiqemi për vendimmarrjen përkatëse.

(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së, z. {...} dhe përfaqësuesja e gjyqtares, znj. {...}. Gjithashtu shkëputet edhe lidhja me të tretët. Mbledhja vijon vetëm në prezencë të anëtarëve.)

(Rifuten në sallën e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së, z. {...} dhe përfaqësuesja e gjyqtares, znj. {...}. Gjithashtu mundësohet edhe lidhja nëpërmjet platformës online.)

Ilir Rusi: U njoftuan, u thirrën dhe u paraqitën përfaqësuesi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe përfaqësuesja ligjore e zonjës {...}.

Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke vendosur “shkarkimin” e magjistrates znj. {...}.

(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesi i ILD-së, z. {...} dhe përfaqësuesja e gjyqtares, znj. {...}.)

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa aktiveve nëpër gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

10. Emona Muçi

(anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. **Naureda Llagami.**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 4. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)**
- 7. Valbona Bala, eksperte EWMI.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 9. BIRN.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa aktiveve nëpër gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje vazhdojmë me pikën 2 të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa aktiveve nëpër gjykata”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën drejtorit z. Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse jeni në dijeni në qershor të vitit 2023 në zbatim të VKM-së nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, dhe në zbatim të vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për organizimin e të dy shkallëve të gjyqësorit dhe të gjykatave administrative, në përfundim të riorganizimit të këtyre gjykatave rezultuan se përfunduan veprimtarinë e tyre gjyqësore 5 gjykata apeli, 9 gjykata të shkallës së parë të rretheve gjyqësore dhe 4 gjykata administrative dhe në përfundim të veprimtarisë gjyqësore dhe ekonomiko-financiare, pranë këtyre gjykatave, përveç infrastrukturës ndërtimore, rezultuan gjendje edhe aktive të ndryshme (të cilat janë aktive afatgjata materiale dhe aktive afatgjata jomateriale) të cilat po i evidentojmë sipas gjykatave si më poshtë:

Rezultuan gjendje në Gjykatën e Apelit Durrës, në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, në Gjykatën e Apelit Korçë, në Gjykatën e Apelit Shkodër, Gjykatën e Apelit Vlorë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, Kavajë, Përmet, Lushnjë, Tropojë, Pogradec, Kurbin, Pukë, Krujë, Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, Vlorë, Durrës, Shkodër, si dhe në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Korçë.

Për këto aktive kanë shprehur interes nisur edhe nga kërkesat që kanë paraqitur gjatë përgatitjes së programeve buxhetore, edhe gjykatat ekzistuese të cilat ngelën pas ristrukturimit të tyre.

Kështu në mbështetje të gjendjes së aktiveve dhe shprehjes së interesit nga këto gjykata, struktura përgjegjëse në KLGJ për administrimin dhe menaxhimin e aktiveve, në bashkëpunim me gjykatat, pasi administroi, vlerësoi dhe verifikoi të gjithë dokumentacionit të dërguar dhe procedurën e ndjekur nga gjykata, arriti në konkluzion se, janë zbatuar të gjitha kërkesat, kriteret dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik si dhe ka vlerësuar kryerjen e rishpërndarjes (transferimit) të aktiveve nëpër gjykata të cilat kanë shprehur interes për plotësimin e nevojave të tyre.

Kështu për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin e aktiveve në

sektorin publik, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të KLGJ-së, shqyrtimin dhe miratimin e relacionit dhe projektvendimit, mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa aktiveve nëpër gjykata, si më poshtë vijon:

-Për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas pasqyrës nr.1.

-Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, sipas pasqyrës nr.2.

-Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, sipas pasqyrës nr.3.

-Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, sipas pasqyrës nr.4.

-Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, sipas pasqyrës nr.5.

-Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, sipas pasqyrës nr.6.

-Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, sipas pasqyrës nr.7.

-Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, sipas pasqyrës nr.8.

-Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, sipas pasqyrës nr.9.

-Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas pasqyrës nr.10.

-Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, sipas pasqyrës nr.11.

-Për Gjykatën Administrative e Apelit Tiranë, sipas pasqyrës nr.12.

-Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas pasqyrës nr.13.

-Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, sipas pasqyrës nr.14 bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Haxhiu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Kalojmë në votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa aktiveve nëpër gjykata”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Të miratojë rishpërndarjen (transferimin) e disa aktiveve nëpër gjykata, nga gjykatat të cilat pas riorganizimit, përfunduan veprimtarinë e tyre, në gjykatat e riorganizuara, sipas pasqyrës nr. 1, deri në pasqyrën nr. 14, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

2. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Gjykata Administrative e Apelit, si dhe Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Lushnjë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa automjeteve në sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. **Naureda Llagami.**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 4. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)**
- 7. Valbona Bala, eksperte EWMI.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 9. BIRN.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa automjeteve në sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 3 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa automjeteve në sistemin gjyqësor”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën z. Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse jeni në dijeni Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 202, datë 17.04.2024 bëri shpërndarjen dhe rishpërndarjen e disa automjeteve në sistemin gjyqësor. Në zbatim të këtij vendimi, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor u administruan edhe disa automjete të përdorura që erdhën nga Gjykata e Lartë. Ndodhur në këto kushte, Drejtoria e Investimeve dhe Planifikimit Strategjik si struktura përgjegjëse, mbështetur në kërkesat e gjykatave si dhe në informacionin që disponon mbi gjendjen e mjeteve të transportit nëpër gjykata, vlerësoi që 5 (pesë) automjetet e përdorura deri tani në pronësi të Gjykatës së Lartë të rishpërndahen për plotësimin e nevojave të pesë gjykatave të tjera.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të KLGJ-së, shqyrtimin dhe miratimin e relacionit dhe projekt vendimit, mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa automjeteve, për nevojat e gjykatave, sipas pasqyrës së mëposhtme.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Ilir Rusi: Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa automjeteve në sistemin gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Të miratojë rishpërndarjen (transferimin) e disa automjeteve në sistemin gjyqësor, sipas pasqyrës bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

2. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, Gjykata e Lartë, Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Fier, Elbasan, Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Lushnjë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi ndryshimin e destinacionit të përdorimit të fondeve në shpenzime korrente, në programet 01110 dhe KLGJ 03310, për vitin buxhetor 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. **Naureda Llagami.**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 4. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)**
- 7. Valbona Bala, eksperte EWMI.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 9. BIRN.**

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi ndryshimin e destinacionit të përdorimit të fondeve në shpenzime korrente, në programet 01110 dhe KLGJ 03310, për vitin buxhetor 2024”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 4 të kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Mbi ndryshimin e destinacionit të përdorimit të fondeve në shpenzime korrente, në programet 01110 dhe KLGJ 03310, për vitin buxhetor 2024”, për të cilën

është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit z. Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse jeni në dijeni me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, është miratuar buxheti për Sistemin Gjyqësor, buxhet i cili me vendimin nr. 743, datë 28.12.2023 është miratuar nga KLGJ-ja detajimi i përdorimit të buxhetit për të gjithë sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024.

Nga departamenti i administrimit të gjykatave dhe IT, si në programim ashtu edhe në detajim u kërkuan fonde në shpenzime korrente, për realizimin e shërbimit, test i penetrimit për përforcimin e sigurisë kibernetike në rrjetin dhe infrastrukturat IT në gjykatat e Republikës së Shqipërisë, në shumën 47,600 mijë lekë si dhe shërbim, test i penetrimit për përforcimin e sigurisë kibernetike në rrjetin dhe sistemet IT në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në shumën 1,400 mijë lekë.

Në datë 10.05.2024, në memon e përgatitur nga departamenti i administrimit të gjykatave dhe IT, na bëhet me dije se nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 26 shkurt 2024, si dhe të kërkesës nr. 128 prot., datë 27.02.2024 të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, AKCESK ka ofruar disponibilitetin për kryerjen e testeve të skanimit të dobësive të sigurisë kibernetike me qëllim parandalimin e incidenteve të mundshme kibernetike, pra komunikuar për mbulimin e këtyre shpenzimeve, një pjesë të këtyre shpenzimeve nga institucioni i AKCESK.

Me qëllim përdorimin me efektivitet të fondeve si dhe për të përmbushur disa nga kërkesat të pasqyruara në raportin i cili është përcjell me shkresën nr. 85/3, datë 05.03.2024 të AKCEKS, me qëllim mirëqeverisjen e sigurisë së informacionit në Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ), si dhe minimizimin e riskut të sigurisë së informacionit dhe afektimin nga incidentet e mundshme kibernetike rekomandojmë të implementohen disa shërbime të tjera që lidhen me fushën e sigurisë kibernetike për një periudhë njëvjeçare, të cilat janë trajtuar hollësisht në memon datë 10.05.2024,

departamenti IT (bashkëlidhur këtij relacioni) i cili kërkon ndryshimin e destinacionit të përdorimit të këtij fondi, nga shërbime të testit të penetrimit në shërbime të tjera në kuadër të masave të sigurisë kibernetike.

Referuar studimit të tregut sipas ofertave të Operatorëve Ekonomik dhe konsultimeve online kostoja e përafërt e këtyre shërbimeve që kërkohen në kuadër të masave të sigurisë kibernetike është përllëgaritur përafërsisht në shumën 49.000 mijë lekë.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozoj seancës plenare të KLGJ-së, shqyrtimin dhe miratimin e relacionit dhe projektvendimit, mbi ndryshimin e destinacionit të përdorimit të fondeve në shpenzime korrente, artikulli 602 nga destinacioni shërbimi test i penetrimit për përforsimin e sigurisë kibernetike në rrjetin dhe infrastrukturën IT, në destinacion shërbime të tjera në kuadër të masave të sigurisë kibernetike, në shumën 1,400 mijë në programin 01110 dhe në shumën 47,600 mijë në programin KLGJ 03310.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, në pritje të një pyetjeje të mundshme.

Ilir Rusi: Ka diskutime?

Ka diskutime?

Po, zoti Toro!

Alban Toro: Atëherë, në aspektin e sigurisë memo plotëson të gjithë efektet që kërkohet për një siguri ndaj sulmeve të jashtëm. Kështu që në këtë aspekt unë do të inkurajoj çfarëdo lloj iniciative të departamentit përkatës që të ndërmarrim masa të tilla dhe natyrisht dhe fondet nuk besoj se do të mungojnë në rritjen e aspektit të sigurisë. Në rastin konkret, të paktën nga pikëpamja e sigurisë, më ka tërhequr dhe më ka pëlqyer i gjithë ky shërbim i cili kërkohet të konvertohet në mbrojtje të sigurisë kibernetike të sistemit të brendshëm të KLGJ-së. Kështu që nuk kam asnjë lloj propozimi përveçse inkurajoj dhe i falënderoj për punën e mirë që kanë bërë në këtë aspekt.

Ilir Rusi: Ka diskutime, komente të tjera?

Meqenëse nuk ka diskutime, komente të tjera, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Mbi ndryshimin e destinacionit të përdorimit të fondeve në shpenzime korrente, në programet 01110 dhe KLGJ 03310, për vitin buxhetor 2024”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e ndryshimit të destinacionit të përdorimit të fondeve në shpenzime korrente, artikulli 602, nga destinacioni shërbimi test i penetrimit për përforcimin e sigurisë kibernetike në rrjetin dhe infrastrukturat IT, me destinacion shërbime të tjera në kuadër të masave të sigurisë kibernetike, në shumën 1,400 mijë në programin 01110 dhe në shumën 47,600 mijë në programin KLGJ 03310.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe IT, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. **Naureda Llagami.**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)

6. Valbona Bala, eksperte EWMI.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

8. BIRN.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 5 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjala për drejtoreshën Ngucaj.

Blerta Ngucaj: Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 91, pika 3 e Ligjit 115/2016, me vendimin nr. 280, datë 10.12.2019, të ndryshuar ka vendosur caktimin e gjyqtarëve, në pozicionin e Gjyqtarit për Mediat në gjykatat e apeleve dhe në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm si dhe në juridiksionin e posaçëm.

Gjyqtari Besmir Stroka, i caktuar si Gjyqtar për Median në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ishte një ndër kandidatët në procedurat e transferimit për lëvizjen paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur nga Këshilli. Pas përmbylljes së procedurës për këtë pozicion për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 214 datë 25.04.2024 ka vendosur:

Transferimin e gjyqtarit z. Besmir Stroka në procedurën e lëvizjes paralele [...].

Sa më sipër, gjyqtari Besmir Stroka, i caktuar si Gjyqtar për Median në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nuk mund ta ushtrojë më këtë funksion pranë kësaj gjykate.

Në vijim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është administruar me aktin nr. {...} prot., datë 09.05.2024, kërkesa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër me nr. {...} prot., datë 08.05.2024, për caktimin e një gjyqtari për mediat pranë kësaj gjykate. Nëpërmjet shkresës së mësipërme drejtuar Këshillit, Zëvendëskryetari i kësaj gjykate ka bërë me dije se, në mbledhjen e trupës gjyqësore të zhvilluar për propozimin e një gjyqtari për mediat, ka shprehur pëlqimin për ushtrimin e kësaj detyre, gjyqtari, z. {...}.

Me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimit kushtetues për informimin e publikut në lidhje me veprimtarinë e gjykatave, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, në zbatim të nenit 91 të ligjit nr. 115/2016 si dhe vendimeve sa më sipër të cituara, të ndryshuara, ka vendosur:

Në pikën 1 të projektvendimit të bëhet ndryshimi i pikës 1 të vendimit të KLGJ-së nr. 280, datë 10.12.2019 (të ndryshuar), duke zëvendësuar gjyqtarin për mediat në

Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, z. Besmir Stroka me gjyqtarin z. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se ngarkohet Gjyqtari për Mediat i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, të marrë masat për zbatimin e këtij vendimi.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi menjëherë e vendimit dhe botimi në faqen zyrtare të internetit.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ngucaj!

Ka diskutime, komente?

Alban Toro: Po!

Blerta doja të pyesja, ky gjyqtari ka shprehur interesin? Ka ndonjë formim të veçantë?

Blerta Ngucaj: Ka shprehur pëlqimin dhe kemi marrë edhe shkresën e zëvendëskryetarit i cili në bazë të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve kanë propozuar këtë emër dhe ne zakonisht kemi ndjekur, Komisioni ka ndjekur praktikën.

Alban Toro: Pra është i vetmi emër që ne kemi përpara, nuk ka ndonjë emër tjetër. Nuk ka ndonjë formim specifik në këtë fushë?

Blerta Ngucaj: Në dijeninë time...

Ne të njëjtën praktikë kemi mbajtur edhe në rastin e mëhershëm në lidhje me gjyqtarin...

Alban Toro: Ideja është që nëse ne vendosim dikë për të bërë këtë punë, duhet që ai të reagojë në një moment kur figura e gjyqtarit cenohet nga jashtë, sepse po ndodhemi shpeshherë në raste kur ka cenime të figurës së gjyqtarit për aktivitetin gjyqësor që ata

kryejnë dhe gjyqtari i medias nuk vepron. Kjo është e patolerueshme. Kështu që në këtë aspekt, të lutem, shiko edhe mundësinë të ndryshojmë aktet tona normative për të bërë me mandat gjyqtarin e medias, me të drejtë ripërsëritje, por duke bërë edhe ne një vlerësim nëse ai ndërhyt apo s'ndërhyt në rastet kur është kërkuar. Mosndërhyrja në mbrojtje të kolegëve të gjykatës, të cilën ai mbulon. Për mua është e patolerueshme. Nuk mund të ndërhyjë vazhdimisht KLGJ-ja për çdo aspekt, çdo cenim të aktivitetit gjyqësor, ndërkohë që paguhet, pra ka një pagesë ekstra për këtë pjesë dhe ka një person specifik i cili edhe njëkohësisht specializohet në fushën e gjyqtarit të medias. Kjo është e gjitha.

Blerta Ngucaj: Po! Në momentin që përzgjidhen, në bazë edhe të pëlqimit që jep gjykata, gjyqtarët e medias i nënshtrohen trajnimeve.

Alban Toro: Nuk e kam në aspektin... se të gjithë kemi qenë të patrajnuar dhe pak nga pak jemi munduar që të marrim njohuri në këtë fushë. Por ideja është tek iniciativa e gjyqtarit në gjykatat përkatëse për të vepruar në momentin që ka një cenim të figurës së gjyqtarit të asaj gjykate, se nuk po themi në të gjithë sistemin gjyqësor, por të asaj gjykate. Kanë ndodhur raste, ka flagrante, kur nuk kemi parë reagime, kur kanë cenuar trupa gjyqësore apo gjykata që kanë dhënë vendim dhe për shkak të vendimit tani ata trajtohen nga subjekte të treta për vendimet që kanë dhënë. Nuk është e tolerueshme, nuk është e pranueshme, nuk është e ... dhe pikërisht ky personi duhet të jetë ai që do t'i mbrojtë. Prandaj them që duhet të shikohet edhe aspekti i mandatimit të tyre, jo të jetë pa limit. Faleminderit!

Klodian Kurushi: (Pa mikrofon) ...duhet të zgjidhet edhe anëtari i KLGJ-së për median, sepse kam përshtypjen anëtari edhe koordinon dhe bashkëvepron me gjyqtarët nëpër gjykata. Në qoftë se bëhet ndonjë kërkesë shqetësim ... normalisht duhet të kemi një koordinim pune ndërmjet anëtarit të KLGJ-së për median dhe gjyqtarin që ndodhet në gjykatën .. (ndërpritet audio).

Ilir Rusi: Ka diskutime të tjera?

(Ndërkohë nis votimi nga anëtarët.)

Jo, jo, të lutem.

Ka diskutime, komente të tjera?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, hedhim në votim projektvendimin.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar””.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Në pikën 1 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019 “Për caktimin e Gjyqtarëve për Mediat”, i ndryshuar me vendimet nr. 292, datë 06.07.2021; nr. 424, datë 29.09.2021; nr. 254, datë 07.07.2022; nr. 515, datë 21.11.2022, nr. 101, datë 06.03.2023; nr. 662, datë 02.11.2023 dhe nr. 248, datë 02.05.2024 gjyqtari për mediat në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, z. Besmir Stroka zëvendësohet në këtë detyrë nga gjyqtari z. {...}.

2. Ngarkohet Gjyqtari për Mediat i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër të marrë masat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional së gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 15.04.2021”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relator znj. Yllka Rupa).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional së gjyqtarës të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 15.04.2021”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relator znj. Yllka Rupa).

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje vazhdojmë me pikën 6 që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional së gjyqtarës së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor

znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 15.04.2021”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale me relatore znj. Rupa.

Yllka Rupa: Faleminderit zoti Rusi!

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 226, datë 02.06.2021, ka vendosur verifikimin e plotësimit të tre kritereve të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës (aktualisht Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm) për gjyqtaren {...}, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021.

Pas plotësimit të Skemës së Vlerësimit të Gjyqtarëve me rregullat për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, miratuar me vendimin e KLGJ është vendosur:

Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 - 15.04.2021, për gjyqtaren, si dhe caktimin e relatorit përkatës.

Pas marrjes së vendimit, ka vijuar procedura e vlerësimit sipas parashikimeve të nenit 86 e vijues të Ligjit të Statusit dhe vendimit nr.159, datë 05.04.2023, duke u kryer të gjitha veprimet e duhura procedurale.

Këshilli me vendimin nr. 37, datë 31.01.2024, pas shqyrtimit të kërkesës së kandidatës për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë, ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit Përgjithshëm, për pozicionin e lire në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr.129, datë 01.04.2021, për znj. {...}.

Pas përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë për shkak të tërheqjes së kandidatës, procedura e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit për gjyqtaren e komanduar në KLGJ, gjatë ushtrimit të detyrës së nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, nuk mund të vazhdojë.

Në kushtet kur procedura e ngritjes në detyrë, për shkak të së cilës ka filluar

procedura e vlerësimit të gjyqtarës {...} për periudhën 01.01.2019-15.04.2021 ka përfunduar, rezulton se, shkak për të cilin procedura e vlerësimit ka filluar nuk ekziston më dhe për pasojë, zhvillimi i kësaj procedure të posaçme vlerësimi, ka humbur qëllimin për të cilin ka filluar.

Në ligjin nr.96/2016 “Për statusin”, nuk ka një parashikim të shprehur për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar, ndërkohë që në nenin 9 të vendimit të KLGJ-së nr.159, datë 05.04.2023, parashikohet vetëm përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit në rastet e mbarimit të statusit të gjyqtarit. Pavarësisht se në aktet e sipërcituara nuk ka një përcaktim të shprehur që rregullon situatën faktike në fjalë, në zbatim të nenit 97, pika 3 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli zbaton K.Pr.Administrative, në nenin 95 të së cilit parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Në rastin konkret, me deklarin e përfundimit të procedurës për ngritjen në detyrë të gjyqtarës, shkak për të cilin ka filluar me prioritet procedura e vlerësimit të gjyqtarës të komanduar, ka rënë shkak për të cilin kjo e fundit ka filluar dhe për këtë arsye, vlerësohet se qëllimi i këtij procesi nuk ekziston më.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-15.04.2021, për shkak të përfundimit të procedurës për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 37, datë 31.01.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se periudha e vlerësimit 2019-2021 do të përfshihet në periudhën e vlerësimit etik dhe profesional në të cilën ajo bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 13, të vendimit të KLGJ-së nr.159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet që një kopje e vendimit për

përfundimin e procedurës së vlerësimit t'i njoftohet gjyqtares {...}.

Në pikën 4 të projektvendimit parashikohet e drejta e ankimit në gjykatë ndaj këtij akti administrativ individual të Këshillit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim "Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 15.04.2021".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtares së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën 01.01.2019 – 15.04.2021 për shkak të përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. 37, datë

31.01.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Periudha e vlerësimit 01.01.2019 – 15.04.2021 do të përfshihet në periudhën e vlerësimit etik dhe profesional në të cilën ajo bën pjesë, sipas parashikimeve të nenit 13, të vendimit të KLGJ-së nr.159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

3. Një kopje e vendimit t’i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Meqenëse kemi shumë pika në rendin e ditës dhe për efektivitet, propozoj të bëjmë 5 minuta pushim.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.235, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 3. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Gentiana Muçaj | <i>(anëtare)</i> |
| 6. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Markelian Koça | <i>(anëtar)</i> |

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. **Naureda Llagami.**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)

6. Valbona Bala, eksperte EWMI.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

8. BIRN.

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.235, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

(Pas disa minutash pushim, rifillon mbledhja plenare.)

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje vazhdojmë me pikën 7 të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.235,

datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, me relator z. Kurushi. Ftoj zotin Kurushi për të bërë një prezantim sintetik për shkak se ne i kemi lexuar materialet.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Zonja {...}, kandidate në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2023, ka paraqitur një kërkesë për tërheqjen e kandidaturës së saj në këtë pozicion. Kërkesa është paraqitur me shkresën e datës 16.05.2024. Bashkëlidhur relacionit besoj se është paraqitur edhe shkresa. Nëse ju doni unë po e lexoj përmbajtjen e saj, por ka tërhequr kërkesën për këtë pozicion.

Ndodhur në këto rrethana, bazuar në vendimin 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, në këtë dispozitë ligjore, përcaktohet ndërmjet të tjerave se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim çështjen përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit”.

Komisioni ka vendosur për ta dërguar çështjen në mbledhjen e Këshillit. Bashkëlidhur relacionit ne kemi paraqitur edhe projektvendimin përkatës ku i propozojmë Këshillit

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235/2023 për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet kandidates, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2023 për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 245, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |

6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 245, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 8 të kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 245, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi, i cili të mbajë të njëjtin qëndrim sintetik.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Meqenëse ne përfunduar pak më parë pra me vendimin paraardhës përfundimin e procedurës pa një vendim përfundimtar për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235/2023, aktualisht po vijoj më tej me dy pozicionet e tjera që janë në proces për verifikimin e kandidates për këto dy pozicione që janë në konkurrim prej saj, që i referohen pozicionit nr. 244 dhe pozicionin nr. 245/2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor që bëjnë fjalë për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile, pra aktualisht kandidatja ka në proces verifikimi 2 pozicione për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile.

Referuar nenit 47 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i paraqet Këshillit procedurën e verifikimit fillimisht të kritereve formale ligjore, në lidhje me vjetërsinë e saj funksionin e magjistratit, vjetërsinë e përgjithshme si dhe vjetërsinë specifike në fushën e të drejtës përkatëse për të cilën kërkohet nga pozicioni që është shpallur i lirë në procedurën e ngritjes në detyrë ku ka kandiduar edhe zonja Guri.

Njëkohësisht Komisioni bëri edhe verifikimin e kritereve që lidhen me pasjen ose jo të masës disiplinore si dhe kriterin tjetër të papajtueshmërisë ose pajtueshmërisë ambientale me pozicionin ku kandidatja ka shfaqur interesin e saj.

Nga të dhënat, pra nga rezultatet e verifikimit paraprak, referuar nenit 47 pika 4 e ligjit “Për statusin” përcaktohet fillimisht që “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vite në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vite në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.

Në lidhje me këtë kriter, Komisioni ka administruar dokumentacionin e nevojshëm, dokumentacion i cili vjen nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit si dhe nga gjykata ku ajo ka ushtruar funksionin e saj si gjyqtare, pra nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Nga përmbajtja e të gjithë dokumentacionit ka rezultuar se me vendimin nr. 1, datë 04.02.1994 Këshilli i Lartë i Drejtësisë emëron ndihmësmagjistrate efektive pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kandidaten znj. {...}.

Me vendim nr. 8, datë 30.08.1996 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendim nr. 137, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, nga data 01.05.2023 kandidatja ushtron funksionin si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit si magjistrat është 30 vite.

Zonja {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallur me vendimet e Këshillit nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi shtatë vite përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidatja ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në fushën civile pranë gjykatës së sipërpërmendur për një periudhë mbi 5 vite.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton që ekzistojnë urdhra të kryetarëve për ndarjen në seksione prej vitit 2008. Gjyqtarja {...} ka gjykuar në seksionin administrativ nga viti 2008 deri në vitin 2013 dhe më pas nga viti 2015 e në vijim ajo gjykon çështje të seksionit civil dhe tregtar.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, referuar informacionit për vendimet e shpallura nga kandidatja, rezulton se, kandidatja ka gjykuar çështje të natyrës civile mbi më tepër sesa 5 vite, kriter i parashikuar nga neni 47/4 i ligjit “Për statusin”.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore”. Nuk ka rezultuar që ajo të ketë masë disiplinore në fuqi, as procedim disiplinor. Pra nuk bëhet pengesë për të bërë verifikimin e kriterëve ligjore të kërkuara nga neni 47.

Njëkohësisht për kandidaten u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”, kriter i cili u verifikua nga deklarata e paraqitur prej kandidates si dhe nga verifikimet që ne kemi bërë në Këshill nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Nga verifikimet na rezulton që kandidatja nuk do të ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale nëse ajo ngrihet në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në fushën e së drejtës civile.

Këto janë verifikimet tona.

Ndodhur në këto kushte, ne i propozojmë Këshillit verifikimin e plotësimit nga kandidatja zonja {...} në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 244 dhe nr. 245, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 244 dhe nr. 245 datë 24.05.2023, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 244, nr. 245 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Priifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 9 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësisimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Relacioni përkatës bashkëlidhet projektvendimit për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për kandidaten znj. {...}.

Me Vendimin nr. 244, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndërmjet të tjerave ka vendosur “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile”.

Në lidhje me këtë pozicion ka shfaqur interes edhe kandidatja {...}.

Ndërmjet të tjerave, referuar nenit 47, pika 4 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni fillimisht ka nisur punën e tij për të realizuar verifikimin fillimisht të tre kritereve ligjore që nevojiten nga kandidatët, nëse ata i plotësojnë apo jo, për të vijuar më tej garën e tyre në pozicionin që ata kanë shprehur interesin e tyre.

Verifikimet lidhen me kriterin e përvojës së përgjithshme profesionale, përvojës minimale specifike profesionale në fushën përkatëse të së drejtës, me masat disiplinore dhe me qenien apo jo në situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Në lidhje me verifikimet që ne kemi bërë për këto tre kritere ka rezultuar se verifikimet mbështeten mbi bazën e dokumenteve që janë mbledhur nga Komisioni referuar korrespondencës dhe marrëdhënieve të krijuara me Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me gjykatën ky zonja {...} ka ushtruar funksionet e saj si magjistratë, si dhe me deklaratat që ka

paraqitur vetë kandidatja.

Sa i përket kriterit të përvojës profesionale minimale dhe pikërisht kriterit të përvojës specifike profesionale të kandidates në fushën e së drejtës përkatëse për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares, konkretisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor sepse ka kryer stazhin fillimisht profesional në këtë gjykatë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, tashmë Gjykatë e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Nga informacioni i kërkuar me shkresat elektronike të datës 23.03.2024 (siç do të përcaktohet më poshtë) nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, informacioni i kërkuar është përcjellë edhe nëpërmjet kësaj gjykate nëpërmjet postës elektronike më datë 21.02.2024.

Rezultatet e verifikimit paraprak.

Ka rezultuar se zonja {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi dhe ka marrë titullin “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në datë 05.07.2002. Ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2008.

Me dekretin e Presidentit të Republikës datë 05.10.2007 emërohet gjyqtare dhe caktohet për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekretin e datës 25.03.2009 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Me vendimin nr. {...}, datë 23.07.2014 të Këshillit të Lartë Drejtësisë emërohet Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Me vendimin nr. 293, datë 09.09.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor miratohet zgjedhja si anëtare e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, me mandat 4-vjeçar.

Me vendimin nr. 97, datë 06.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet përkohësisht për një periudhë 1-vjeçare gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nga data 01.05.2023 ka ushtruar funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Me vendimin nr. 456, datë 24.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor transferohet

sipas procedurës së lëvizjes paralele, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku dhe aktualisht ajo ushtron funksionin e saj pranë kësaj gjykate.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 16 vite.

Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Në lidhje me rezultatet e verifikimit për përvojën specifike profesionale, ka rezultuar se në kërkesën për shprehje interesi kandidatja ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në gjykatën civile pranë gjykatave të sipërpërmendura më lart, për një periudhë kohore të gjatë. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton që kandidatja prej marsit 2023 e në vijim është pjesë e seksionit civil të kësaj gjykate.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për kandidaten rezulton si vijon:

- Sipas urdhrorit nr. {...} prot., datë 10.01.2011, “Për ndarjen e gjyqtarëve në dhoma e seksione për vitin 2011-2012”, rezulton se znj. {...} është pjesë e seksionit civil tregtar”;

- Sipas urdhrorit nr. {...} prot., datë 04.01.2013, “Për ndarjen e gjyqtarëve në dhoma e seksione për vitin 2011-2012”, rezulton se gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë do të gjykojnë pa ndarje në dhomë civile dhe dhomë penale.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 244, datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi pesë vite përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

Nga verifikimet tona rezulton që kandidatja nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Është verifikuar edhe kriteri i papajtueshmërisë ambientale dhe nga këto verifikime deri në këtë situatë ku ndodhemi sot, Komisioni vlerëson që kandidatja nuk do të ndodhet në pozitën e papajtueshmërisë ambientale nëse ajo do të ngrihet në detyrë në pozicionin ku ka shprehur interesin, pra pozicionin 244/2023, të shpallur me vendim të

Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ndodhur në këto kushte ne i propozojmë Këshillit verifikimin e plotësimit të kritereve të përmendura më lart. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 244, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 244, datë 24.05.2023, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”

dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 244, datë 24.05.2023.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 10 të kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të

drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej, fjala për relatorin z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Paraqesim relacionin për projektvendimin e përfundimit të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}.

Këshilli me vendimin nr. 503, nr. 504, datë 21.11.2022, ka vendosur hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë (në atë kohë) dhe apelit Korçë (në atë kohë), por që aktualisht i referohemi apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për pozicionet 503, 504 në fushën e së drejtës penale.

Në lidhje me këto vende të hapura me vendim të KLGJ-së ka paraqitur kërkesën fillimisht zonja {...}. Për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 503, kandidatja fillimisht ka paraqitur një kërkesë për tërheqjen e saj nga kandidimi për këtë pozicion dhe në lidhje me këtë kërkesë, këshilli me vendimin nr. 124, 11.03.2024 vendosi përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 503.

Më pas, për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 504, 21.11.2022 kandidatja ka paraqitur edhe një herë një kërkesë të re ku ka shprehur vullnetin për heqje dorë nga ky pozicion nëpërmjet postës elektronike datë 26.03.2023, vullnet të cilin e konfirmoi sërish nëpërmjet postës elektronike datë 15.04.2024, duke parashtruar (po lexoj përmbajtjen) shkurtimisht: Heq dorë nga kandidimi për pozicionin e lirë penal të shpallur për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022.

Ndodhur në këto kushte, duke iu referuar vendimit të KLGJ-së nr. 70, datë 07.02.2020 për kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë, ku ndër të tjera përcaktohet se kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim, rezultoi se

në rastin konkret ndodhemi përpara të njëjtave situata siç parashikon dispozita që unë citova më lart në vendimin nr. 70/2020 të KLGJ-së, kështu që ne i propozojmë Këshillit të përfundojë procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime).

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 504 datë 21.11.2022, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.235 dhe nr.236, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. **Naureda Llagami.**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)

6. Valbona Bala, eksperte EWMI.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

8. BIRN.

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.235 dhe nr.236, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 11 të kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.235 dhe nr.236, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni

nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar kolegë, kemi përgatitur projektvendimin e radhës “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.235 dhe nr.236, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}”. Bashkëlidhur projektvendimit kemi relacionin.

Në mënyrë të përgjithshme po prezantoj relacionin e përgatitur.

Me vendimet nr. 235 dhe nr. 235, datë 24.05.2023, respektivisht KLGJ ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Njëkohësisht, me vendimin nr. 240, datë 24.05.2023 të KLGJ-së, Këshilli hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e së drejtës civile. Për të tre këto pozicione ka paraqitur kërkesë, duke shprehur interes, kandidati zoti {...}.

Më tej, gjatë procedurës së verifikimit, në lidhje me plotësimin e tre kriterëve fillimisht ligjore për të vijuar garën në pozicionet 234, 235 (*pozicionet janë 235, 236*) (Gjykata e Apelit Administrativ) dhe në pozicionin 240 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në vijimin e këtyre procedurave, zoti {...} paraqet një kërkesë në Këshillin e Lartë Gjyqësor, ku ndërmjet të tjerave ai parashtron (pra kërkesa është e datës 16.05.2024 dhe është protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} dhe ndërmjet të tjerave ai parashtron: Unë kam konkurruar për t’u ngritur në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për pozicionet nr. 235 dhe nr.236. Me anë të kësaj kërkesë heq dorë nga konkurrimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm (*duhet të jetë lapsus, pasi gjykata është Gjykata Administrative e Apelit*) për vendimet e shpallura për pozicionet e lira nr. 235/236, datë 24.05.2024. Mbetem me shpresë se kërkesa ime do të merret në konsideratë.

Ndodhur në këto kushte, referuar vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e

gjqtarëve të Gjykatës së Lartë”, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr”, relatori e dërgon menjëherë projektvendimin së bashku me relacionin përpara Komisionit i cili më pas nëse dakordësohet me propozimin e relatorit, dërgon materialet përkatëse në Këshill.

Ndodhur në këto kushte, ne kemi dërguar relacionin përkatës së bashku me dokumentet në Këshill dhe propozojmë për shkak të tërheqjes së kandidatit nga dy pozicionet e përmendura më lart, me nr. 235 dhe 236 që i përkojnë pozicioneve të lira, vakancave të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Gjykatën Administrative të Apelit, ne i propozojmë Këshillit që të përfundojë procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për pozicionet nr.235, nr.236, datë 24.05.2023, të shpallura me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën

Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.235 dhe nr.236, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235 dhe nr. 236, datë 24.05.2023 për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 11 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 12 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 240 datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Priifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 240 datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 12 të kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 240 datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Meqenëse paraprakisht morëm vendimin për përfundimin e procedurës për dy pozicionet ku paraprakisht kishte shprehur interesin dhe më pas tërhoqi kërkesën zoti {...} për pozicionin 235 dhe 236, datë 24.05.2023, pra për pozicionet e shpallura me këto vendime në Gjykatën Administrative të Apelit, ne kemi dërguar në Këshill verifikimin e plotësimit nga kandidati të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 240, datë 24.05.2023. Pra përveç atyre pozicioneve/kërkesave që ai hoqi dorë, kishte edhe një kërkesë e tretë, për të cilin ne kemi bërë verifikimet përkatëse dhe sot paraqesim në Këshill relacionin përkatës, së bashku me projektvendimin.

Edhe për zotin {...} ne kemi bërë verifikimin e tre kritereve ligjore, referuar nenit 47, pika 4 e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke marrë në konsideratë verifikimin e tre kritereve ligjore të parashikuara nga dispozitat ligjore të ligjit “Për statusin”, fillimisht 47 parashikon përvojën e përgjithshme si magjistrat si dhe përvojën minimale specifike në fushën përkatëse ku kandidati ka konkurruar, dhe nga të gjitha verifikimet tona ka rezultuar se z. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës më datë 11.07.1995. Njëkohësisht ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2000 si dhe ka përfunduar pranë Universitetit të Tiranës, studimet Master në “E drejtë civile” në vitin 2006 dhe në vitin 2016 ka fituar gradën shkencore “Doktor” në temën “E drejta e

pronësisë”.

Me vendimin nr. {...}, datë 04.09.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet provizorisht gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

Me dekret nr. {...}, datë 27.09.2000 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendimin nr. 137, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, nga data 01.05.2023 ushtron funksionet si gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 24 vite.

Zoti {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Pra, nga të dhënat e mësipërme, që janë kritere të cilat i kërkon pozicioni i shpallur me vendimin nr. 240, datë 24.05.2023 rezulton se z. {...}, ka mbi shtatë vite përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidati ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në fushën civile dhe administrative pranë gjykatës së sipërpërmendur për një periudhë të paktën prej 5 vitesh.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton që gjenden urdhra të kryetarëve për ndarjen në seksione prej vitit 2008 nga ku rezulton se gjyqtari {...} ka gjykuar në seksionin administrativ në vitin 2008 dhe më pas nga viti 2011 e në vazhdim në seksionin civil dhe në seksionin tregtar të kësaj gjykate.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidati z. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 240 datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

Nga verifikimet e kriterit të mospasjes masë disiplinore, z. {...} ka rezultuar se nuk ka masa disiplinore në fuqi, si dhe nga verifikimet e mëtejshme që lidhen me kriterin

e papajtueshmërisë ambientale, deri në këto momente ku ne kemi bërë verifikimet tona, ka rezultuar se nëse zoti {...} do të ngrihet në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e së drejtës civile, ai nuk do të ketë shkak për të qenë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale nëse ngrihet në detyrë në atë pozicion për të cilin ai ka shprehur interesin.

Ndodhur në këto kushte ne paraqesim projektvendimin tonë përkatës për verifikimin e plotësimit të këtyre tre kritereve. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 240, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në

detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 240, datë 24.05.2023, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 240, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 12 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 13 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 13 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të

shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Po prezantoj projektvendimin për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}.

Me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur: 1. Hapja e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë në fushën e së drejtës penale.

Në lidhje me këtë vendim, pas shpalljes së vendeve, ka shprehur interesin edhe kandidati zoti {...}.

Më tej, Komisioni dhe Këshilli vijuan procedurën për verifikimin e kriterëve ligjore që kërkonte pozicioni për të cilin z. {...} ka shprehur interesin e tij për të kandiduar, që është pozicioni i lirë në atë kohë në Gjykatën e Apelit Korçë, në fushën e së drejtës penale.

Me vendimin nr. 511, datë 21.11.2022, Këshilli vendosi verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 178, datë 11.05.2022, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 178/2022.

Në vijim të procedurës për verifikimin e kriterëve të tjera ligjore, me kërkesën e datës 15.05.2024 që është protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., z. {...} paraqiti një kërkesë për heqje dorë nga kandidimi, duke theksuar në kërkesën e parashtruar se: “...paraqes dorëheqjen time nga kandidimi për pozicionin e lirë për ngritje në detyrë në

Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022”.

Ndodhur në këto kushte, referuar vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, në të cilën përcaktohet ndër të tjera se: “Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin përkatës që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit”, ka rezultuar që janë plotësuar të gjitha ato rrethana që parashikon pikërisht vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75 i vitit 2019. Pra me tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatiti relacionin. E parashitroi fillimisht në Komision, i cili u dakordësua dhe çështja ka kaluar në Këshill me propozimin për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këto pozicione (*për këtë pozicion*).

2. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 13 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 14 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 236, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

14. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 236, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 14 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të

shpallur me vendimin nr. 236, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Hado.

Ridvan Hado: Faleminderit!

Me vendimin nr. 236, datë 24.05.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka vendosur: 1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Me vendimin nr. 57 datë 07.02.2024, Këshilli ka vendosur: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë [...]. Më pas është hedhur shorti, nga i cili jam caktuar unë si relator.

Në mbledhjen e datës 29.02.2024, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke e konsideruar të plotë procedurën e verifikimit të tre kriterëve formale të kandidimit të zonjës {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vlerësim.

Në mbledhjen plenare të datës 13.03.2024, Këshilli pa filluar shqyrtimin e akteve të procedurës së verifikimit të kësaj kandidateje ka vendosur që t’i shqyrtojë në një mbledhje tjetër së bashku me kandidatët e tjerë që kanë kandiduar për ngritje në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke pasur parasysh faktin se kandidatja ushtron funksionin e gjyqtarit në një gjykatë që nuk i përkiste juridiksionit administrativ.

Ndërkohë, me datë 15.05.2024, kandidatja znj. {...} ka parashtruar kërkesë për tërheqjen nga kandidimi për ngritje në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 236, datë 24.05.2023.

Në kushtet sa më sipër, kur tashmë çështja ndodhet për shqyrtim në mbledhje plenare, duke konsideruar dhe vlerësuar të rregullt, të qartë dhe të plotë vullnetin e

shfaqur nga kandidatja znj. {...}, për t'u tërhequr nga kandidimi, për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 236, datë 24.05.2023, ia parashtroj për shqyrtim mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur mbi përfundimin e kësaj procedure për ngritjen në detyrë, për shkak të tërheqjes së kandidates nga kandidimi.

Ju faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hado!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 236, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin nr. 236, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj.

{...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 14 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 15 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

15.1 Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarit z. {...}.

15.2 Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarit z. {...}.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

15. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

15.1 Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarit z. {...}.

15.2 Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarit z. {...}.

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të kësaj mbledhjeje, ju bëj me dije së në postën tuaj elektronike ka ardhur një kërkesë me karakter urgjent nga Gjykata e Posaçme e Apelit, me qëllim përcaktimin e një gjyqtari përkatës, në lidhje me një çështje gjyqësore, seanca e të cilës është më datë 31.05.2024 (pra pasnesër, ditën e premte).

Jeni dakord për ta përfshirë në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje?

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë, në rendin e ditës së sotme përfshihet edhe shqyrtimi i kësaj çështjeje. Ftoj administratën të shpërndajë materialet përkatëse pranë anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Vazhdojmë me pikën 15 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, konkretisht:

“Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarit z. {...}” dhe si nënçështje e dytë e kësaj pike është “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarit z. {...}”. Është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Në vijim z. Kurushi, meqenëse këto dy nënçështje janë pjesë e pikës 15, në mënyrë sintetike do na i prezantosh.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Ne i kemi paraqitur materialet në Këshill. Janë dy projektvendime, por është një relacion, për shkak se çështjet janë të ndërvarura me njëra-tjetrën.

Shkurtimisht për z. {...}, pasi është caktuar në pozicion të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka bërë konflikt çështjen gjyqësore të tij pasi ka kërkuar që ai të caktohet në një pozicion të përhershëm në gjykatën ku ka ushtruar funksionin përpara se sa të përfundonte procesi i rivlerësimit kalimtar me një vendim përfundimtar.

Vendimi i gjykatës së apelit, i cili më pas është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, ka detyruar Këshillin e Lartë Gjyqësor që t'i caktojë pozicionin e përhershëm zotit {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, pozicion që ai e ka pasur përpara se sa të përfundonte procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve.

Ndodhur në këto kushte, për z. {...} neve si Këshill propozojmë të... jemi vetëm në fazën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, pra do marrim vendimin gjyqësor të Gjykatës së Apelit Administrativ dhe vendimin e Gjykatës së Lartë që e ka lënë në fuqi dhe të ekzekutojmë këtë vendim, duke e caktuar z. {...} në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Në të njëjtën situatë të rrethanave faktike dhe ligjore ndodhet edhe çështja për gjyqtarin z. {...}. Zoti {...} ka marrë së fundmi, përfundimisht, vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit me nr. 24, datë 22.05.2024, vendim i cili e ka konfirmuar në detyrë si gjyqtar. Meqenëse çështja e z. {...} është në rrethanat faktike e njëjtë me z. {...}, ne kemi bërë propozimin që edhe për z. {...}, të caktohet në mënyrë të përhershme, pasi ai është konfirmuar me statusin e magjistratit, t'i caktohet pozicioni i përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, pozicion të cilin ai e ka pasur përpara fillimit dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i ashtuquajtur edhe ndryshe ligji për vetingun e gjyqtarëve.

Ndodhur në këto kushte, ne, në të njëjtin relacion, në mënyrë të përmbledhur kemi

parashtruar dy projektvendime, për sa kohë ato janë të ngjashëm me njëri-tjetrin.

Projektvendimet diferencojnë për shkak të pozicionit dhe ushtrimit të funksioneve faktike që bëjnë magistratët nga njëri-tjetri. Ku ka dallim? Meqenëse z. {...} nuk ka ushtruar funksione, pasi vendimi është marrë në datë 22.05.2024 nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, ne si Komision i propozojmë Këshillit që efektet e vendimit për caktimin e tij në një pozicion të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të jetë i menjëhershëm, pasi ai nuk ka ngarkesë në detyrë, nuk ka ushtruar funksionin në mënyrë të përkohshme në një gjykatë tjetër dhe nuk ka çështje në shqyrtim.

Ndërsa për z. {...}, i cili aktualisht, para se sa të merrej vendimi i Gjykatës së Lartë që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, ai ushtronte funksionet mbi bazën e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, aktualisht ai ka disa çështje në gjykim. Me qëllim që ai të përmbushi detyrimet për çështje të cilat ai i ka në gjykim, mund t'i ketë në fazën e konkluzioneve përfundimtare, ose çështje të natyrës urgjente ose emergjente, ne si Komision propozojmë që t'i lëmë një afat të arsyeshëm, afat i cili do ta ndihmojë zotin {...} për të përfunduar dhe për të dorëzuar të gjitha çështjet që ai ka në ngarkim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë. Ne propozojmë në këtë rast që t'i lihet një afat i arsyeshëm prej 3 javësh, duke përfshirë në këtë afat edhe faktin që ai aktualisht ndodhet si gjyqtar i gatshëm në shqyrtimin e kërkesave urgjente, që janë masat e sigurimit, kërkesat për vleftësim, arresti ose vleftësim urdhrash ndalimi nga ana e prokurorit apo policisë gjyqësore. Bashkëlidhur relacionit, në mënyrë të shkurtuar unë paraqes edhe projektvendimet përkatëse.

Nëse keni pyetje apo diskutime jam i hapur. Faleminderit!

Ilir Rusi: Zoti Kurushi, ju falënderoj për prezantimin sintetik.

Vetëm të lutem më saktëso datën kur fillon efektet sepse ju përmendët tre javë, por duke e lidhur me datën e zhvillimit të mbledhjes plenare të ditës së sotme, përcakto datën.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

E drejtë!

Për z. {...} ne propozojmë që efektet juridike të këtij vendimi të fillojnë më datë 19.06.2024, siç thashë, tre javë. Tre javë i bie data 19.06.2024. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Keni diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, do vazhdojmë fillimisht me votimin e projektvendimit në lidhje me z. {...}.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarit z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojmë më datë 19.06.2024.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të

Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me votimin e projektvendimit që ka të bëjë me magjistratin {...}. Keni diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarit z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të

Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 15 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 16 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. **Naureda Llagami**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)

6. Valbona Bala, eksperte EWMI.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

8. BIRN.

RENDI I DITËS:

16. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 16 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën

relatorit, ka një ndryshim, ishte z. Kurushi, e ka z. Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Përmbajtja e relacionit në fjalë ka lidhje me institutin e komandimit dhe konkretisht të një trupe gjyqësore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Paraqitja frekvente e këtij relacioni pranë këtij paneli dëshmon, e ka memorizuar tashmë dhe ky fakt më bën të mos e citojë fjalë për fjalë, por njëkohësisht provon edhe përpjekjet që ka bërë Këshilli i Lartë Gjyqësor në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për të integruar trupa gjyqësore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi kemi vlerësuar që trupat gjyqësore, si ekspertë të ligjit, do të mundësojnë të ndihmojnë Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të realizojë objektivat e tij dhe shpeshherë ndoshta edhe të korrektojë aktivitetin e tij siç kemi pasur dëshmi edhe në rastin tonë konkret gjatë aktivitetit që kemi zhvilluar si organ administrativ në përmbushjen e detyrimeve tona kushtetuese. Gjithsesi, në dispozitivin e këtij projekti që shoqëron relacionin është vendosur dhe detajuar hapja e procedurës dhe shpallja e kërkesës për kandidatura, kohëzgjatja, kushtet, kriteret dhe procedurat e komandimit. Si afat të fundit të paraqitjes për komandim kemi parashikuar afatin dyjavor në momentin që është përpiluar ky relacion dhe ndërkohë kemi caktuar/fiksuar datën 12 qershor 2024, si datë të fundit për paraqitjen dhe administrimin e kërkesave të fundit për komandim.

Gjithsesi do të sugjerim që të gjithë gjyqtarët të cilët plotësojnë kriterin minimal të paktën 13 vjet në nivelet si gjyqtarë, t'u mundësohet dhe t'u çohet një e-mail specifik në postën e tyre zyrtare, qoftë edhe private, për të sensibilizuar dhe për të mundësuar informimin sa më mirë të trupës gjyqësore për shprehjen e interesit nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për elementë të trupës gjyqësore pranë kësaj zyre.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Keni diskutime?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk keni diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

I. Hapja e procedurës dhe shpallja e kërkesës për kandidatura

1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për 3 (tre) pozicione të lira.

3. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është data 12.06.2024.

Struktura e mëtejshme e këtij vendimi është sipas standardeve dhe propozimit të bërë nga relatori.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 16 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 17 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 66, datë 09.02.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 3. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |

- | | |
|--------------------------|------------------|
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 10. <i>Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

17. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 66, datë 09.02.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë

21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 17 të mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 66, datë 09.02.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Rusi!

Në mbledhjen e datës 12.12.2023, me vendimin nr. 738, datë 12.12.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/b dhe 149, pika 5 e Kushtetutës së Republikës, në nenin 276, pika 7 e ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në vendimin e Mbledhjes së Përgjithshme të gjyqtarëve më datë 09.10.2023, vendosi deklarinimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të tij, z. {...}. Vendimi i mësipërm hyri në fuqi menjëherë.

Me anë të vendimit nr. 742, datë 26.12.2023 “Për një ndryshim në vendimin nr.13, datë 18.01.2019 të KLGJ-së të ndryshuar, “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 62 të ligjit nr. 115/2016, vendimit nr.13, datë 18.01.2019 të KLGJ “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme”; vendimin nr. 742, datë 26.12.2023 të KLGJ, është vendosur që përbërja e Komisioneve të Përhershme të vijojë si më poshtë: “... Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (KZHK) Anëtarë: Klodian Kurushi, Markelian Koça, Alban Toro. Anëtarë Zëvendësues: Ridvan Hado dhe Ilir Rusi.”

Bazuar në dosjet dhe materialet e ish-anëtarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës z. {...}, rezulton që kandidatët, dosjet e të cilëve janë administruar nga ai (për të cilat, me vendimet respektive të cituara më lart është caktuar relator) janë:

Dosje e kandidates për ngritje në detyrë në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, znj. {...};

Dosje e kandidatit për ngritje në detyrë në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, z. {...};

Dosje e kandidates për ngritje në detyrë në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, znj. {...}.

Caktimi i relatorit dhe propozimi i komisionit (pasi thashë ishte larguar zoti {...} që kishte tre kandidatët në proces verifikimi):

Në Kreun V, Seksioni A, pika 2, të vendimit të Këshillit nr. 75/2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, është përcaktuar ndër të tjera se: “Shorti realizon shpërndarjen rastësore dhe të barabartë, në vijimësi, të ngarkesës së punës, midis anëtarëve të Komisionit.”.

Në zbatim të këtij rregulli, Këshilli duhet të caktojë relatorët për secilin nga kandidatët, midis anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Për arsye praktike dhe për një shpërndarje të barabartë të ngarkesës së punës mes anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ne si Komision i propozojmë Këshillit që anëtari i Komisionit z. Markelian Koça të caktohet relator për këta 3 (tre) kandidatë. Pra mos të hidhet shorti. Domethënë zoti {...} ka lënë çështjet e tij dhe meqenëse z. Koça tashmë është anëtari i tretë i këtij Komisioni, z. Koça të marrë për ngarkesë, për të balancuar edhe ngarkesën midis anëtarëve, çështjet që i ka pasur në proces të pambyllura nga z. {...}. Tre çështjet janë ato që unë i përmenda më lart, i referohen kërkesave dhe verifikimi i tyre nga kandidatët {...}; {...}; {...}, për pozicionet e shpallura në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, shkallë e parë, në nëntor të vitit 2022, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Faleminderit për vëmendjen.

Këto janë propozimet tona.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime? Jo vetëm në përmbajtje të projekt-aktit por edhe të faktit që përjashtohet shorti dhe të vazhdohet më tej me z. Koça.

Klodian Kurushi: Për arsye ngarkese.

Ilir Rusi: Për arsye ngarkese, patjetër. Dhe shpërndarje të barabartë të punës ndërmjet anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës. Nëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 66, datë 09.02.2023 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503, 504 datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 66, datë 09.02.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, nënpika 4, si më poshtë:

Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Markelian Koça.

2. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 66, datë 09.02.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, nënpika 8, si më poshtë:

Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidatin z. {...}, relator z. Markelian Koça.

3. Ndryshimin pjesërisht të pikës 2 të vendimit nr. 66, datë 09.02.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr.499, nr.500, 501, datë 21.11.2022; si edhe në Gjykatën e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 502, nr.503, 504, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, nënpika 15, si më poshtë:

Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Markelian Koça.

4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet secilit prej kandidatëve të përfshirë në pikën 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 17 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 18 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm nr.299, datë 13.07.2021 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit për këshilltar ligjor, z. {...}”, dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të verifikimit të pasurisë dhe figurës”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

18. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm nr.299, datë 13.07.2021 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit për këshilltar ligjor, z. {...}”, dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të verifikimit të pasurisë dhe figurës”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 18 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm nr.299, datë 13.07.2021 “Për

pezullimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit për këshilltar ligjor, z. {...}”, dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të verifikimit të pasurisë dhe figurës”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën znj. Ngucaj.

Blerta Ngucaj: Faleminderit!

Zoti {...} është kandidat për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë. Në zbatim të pikës 144 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ) nr. 424 datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, pasi ka përfunduar vitin akademik 2019-2020, z. Shani është emëruar përkohësisht në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë.

Me vendimin nr. 497, datë 21.10.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për pranim në shërbimin civil gjyqësor, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor”, bazuar në nenet 53, 55 dhe 83 të ligjit nr. 98/2016, si dhe vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore...” si më sipër, KLGJ ka filluar procedurën e verifikimit për pranimin në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve që kanë përfunduar me sukses formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, ndër të cilët është edhe z. Shani. Pas zhvillimit të procedurës së shortit është caktuar relatore anëtarja e Këshillit, znj. Brikena Ukperaj (Lubonja).

Rezulton se z. Shani ka ushtruar profesionin e ndihmësit ligjor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Për shkak të këtij funksioni z. Shani është cilësuar subjekt rivlerësimi, duke iu nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar në bazë të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, në të cilin parashikohet se të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, dhe pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio.

Rezulton se objekti i verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për pranim në shërbimin civil gjyqësor, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor, i filluar nga KLGJ me vendimin nr. 497, 21.10.2020, përfshin verifikimin e plotë të pasurisë dhe figurës së kandidatit, duke përfshirë të gjithë periudhën, deri në momentin e fillimit të procesit të verifikimit në datë 21.10.2020. Për pasojë, në këtë periudhë verifikimi përfshihet edhe periudha kohore para datës 27.01.2017, periudhë e cila përfshihet njëkohësisht edhe në periudhën e rivlerësimit kalimtar në bazë të parashikimeve të Kushtetutës.

Në këto kushte, procedura e verifikimit të pasurisë dhe figurës në kuadër të procesit të verifikimit të filluar nga KLGJ, nuk mund të vijonte, pa u shprehur më parë organet e rivlerësimit.

Sa më sipër, me vendimin nr. 299, datë 13.07.2021, KLGJ vendosi: “Pezullimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit për këshilltar ligjor z. {...}, të filluar me vendimin nr. 497, datë 21.10.2020 deri në përfundimin me vendim të formës së prerë të procedurës së verifikimit nga organet e veting”.

Më tej, me vendimin nr. 746, datë 20.03.2024, KPK ka vendosur: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit {...}, ndihmës ligjor, aktualisht me detyrë këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë”, vendim i cili ka marrë formë të prerë më datë 09.05.2024.

Në këto kushte, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke qenë se ka marrë formë të prerë dhe duke qenë se shkak i pezullimit i vendosur me vendim të ndërmjetëm të Këshillit ka rënë dhe organet e rivlerësimit kanë disponuar me një vendim të formës së prerë për subjektin e rivlerësimit, Këshilli duhet të disponojë në lidhje me vendimin e ndërmjetëm. 10. Ky disponim vendoset nga Këshilli në përputhje me nenin 68/2 të Kodit të Procedurave Administrative, duke qenë se kemi të bëjmë me shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm datë 13.07.2021, me nr. 299, në kushtet kur shkaqet e ekzistencës së tij kanë pushuar së ekzistuari.

Në vijim, në kushtet e fillimit të një procedurë administrative individuale, do të vijohet me procedurën e caktimit të relatorit. Sjellim në vëmendje se Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit për vitin akademik 2019 – 2020 si dhe caktimin e relatorit për secilin prej tyre. Rezulton se për kandidatin në fjalë, relator ka qenë znj.

Brikena Ukperaj.

Në kushtet kur kjo e fundit i ka përfunduar mandati si anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 736, datë 12.12.2023, në zbatim të pikës 12 të Kreut IV të vendimit nr. 424/2020, lind nevoja për të realizuar sërish procedurat e shortit, me qëllim caktimin e relatorit për kandidatin z. {...}. Relatori i procedurës caktohet me short, ndërmjet anëtarëve të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ky Komision ka në përbërje Kryetaren, znj. Gentiana Muçaj dhe znj. Fatmira Luli.

Referuar pikës 2, të nenit 63, të Ligjit nr. 115/2016 znj. Llagami, njëkohësisht Kryetare nuk mund të jetë relatore në procedura në të cilat Komisioni ose Këshilli duhet të miratojnë akte administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose nëpunësve civilë gjyqësorë.

Në këto rrethana, shorti për relator për kandidatin z. Shani do të realizohet mes znj. Muçaj dhe znj. Luli.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Nguçaj!

Ka diskutime? Jo vetëm në përmbajtjen e relacionit, por edhe për mekanizmin e hedhjes së shortit.

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, edhe mbi mekanizmin e hedhjes së shortit, ftoj administratën për të hedhur shortin.

Procedura e hedhjes së shortit:

Në enë vendosen shiritat e letrës me emrat e dy relatorëve: znj. Fatmira Luli dhe znj. Gentiana Muçaj.

Procedura e përzgjedhjes nga shorti:

Relatori i përzgjedhur rezulton znj. Gentiana Muçaj.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Keni diskutime mbi përmbajtjen e projekt-aktit me përditësimet së fundmi për shkak të përmbajtjes së shortit të sapo hedhur?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk keni diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm nr.299, datë 13.07.2021 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit për këshilltar ligjor, z. {...}” dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të verifikimit të pasurisë dhe figurës”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm nr. 299, datë 13.07.2021 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit për këshilltar ligjor z. {...}” dhe vijimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin për këshilltar ligjor z. {...}, pas marrjes formë të prerë të vendimit për verifikimin nga organet e rivlerësimit.

2. Caktimin e znj. Gentiana Muçaj relatore të kësaj procedure.

3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet z. {...}.

4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar që do të merret nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përfundim të procedurës së verifikimit pasurisë dhe figurës së z. {...}, kandidati për këshilltar ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë

Gjykatës së Lartë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 18 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.05.2024)

Pika 19 shtesë¹ e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:19 dhe mbaroi në orën 14:04.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 3. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Gentiana Muçaj | <i>(anëtare)</i> |
| 6. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |

¹ Shih fillimin e procesverballit të pikës 15.

8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arturo Valdes dhe Arben Lila, ekspertë të Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *BIRN.*

RENDI I DITËS:

19 (Pikë shtesë). Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje do vazhdojmë tashmë me pikën 19 të saj, pikë e cila u shtua për shkak të urgjencës për t’u shqyrtuar në këtë mbledhje plenare për caktimin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit, sipas kërkesës urgjente, pikë e

shtuar me një votim përgjatë mbledhjes dhe për shkak të urgjencës së saj. Për më tej fjalën relatori z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Për shkak të urgjencës, më datë 29.05.2024, pranë KLGJ-së, janë regjistruar për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, kërkesë e parashtruar nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas të dhënave të më poshtme. Bëhet fjalë për një çështje penale. Objekti i akuzës i referohet neneve 284/1, 28/4, 283/a/1, 287/1/b-25, 333/a/1, 334/1 të Kodit Penal. Numri i gjyqtarëve që kërkohet të caktohet është një. Numri i kërkesës është 745. Numri i çështjes është 31.

Kërkohet caktimi i 1 (një) gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues në gjykimin e çështjes penale që zhvillohet në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, pasi në këtë rast gjykohet çështja me të pandehur shtetasin {...} etj. Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët: znj. {...} dhe {...}. Kanë pengesë për të gjykuar çështjen e mësipërme gjyqtarët: {...}, ka qenë gjyqtarë të hetimeve paraprake; {...} ka qenë gjyqtare e hetimeve paraprake në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, shkallë e parë; znj. {...}, {...}, {...}, {...}, {...} kanë qenë gjyqtarë të gjykimit të një çështjeje themeli ndaj disa bashkë të pandehurve të tjerë në një procedim të lidhur.

Ndodhur në këto kushte, meqenëse janë ezauruar të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për të plotësuar trupin gjykues me tre gjyqtarë, pra kërkohet një i tillë, në këtë rast ne si komision propozojmë të vihet në zbatim mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme.

Mekanizmi i transferimit të përkohshëm të gjyqtarit dhe ai i skemës së delegimit bëhen të pamundur për t'u aplikuar në rastin konkret. Duke marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara në paragrafin X/2 të vendimit të KLGJ-së të miratuar për këtë qëllim si dhe në zbatim të paragrafit VI, pika 4, të këtij vendimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre që kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Për 1 (një) çështje, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, të përzgjidhet me short 1 i tillë, ndërmjet gjyqtarëve të seksionit penal të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm që plotësojnë kriteret e përmendura më lart.

Përfundimet nga shorti:

Referuar paragrafit VIII të vendimit të KLGJ-së, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm znj. {...}, për shkak të pozicionit që ajo mban si zëvendëskryetare.

Bashkëlidhur propozimeve ndodhet edhe lista e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm që plotësojnë kriteret e kërkuara për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore në Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në shkallë të dytë, në nivel apeli. Pra 10 vjet përvojë. 5 vjet si gjyqtar për çështjet penale.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Keni diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk keni diskutime, administrata ftohet të vazhdojë me hedhjen e shortit.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesa nr. 745), gjyqtarja Miranda Andoni.

Ilir Rusi: Me hedhjen e shortit, shqyrtohen të gjitha pikat e kësaj mbledhjeje, të këtij rendi dite. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Pasdite të qetë.

* * *

(Pika 19 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor